

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Diplomacia e dollarit" e Jared Kushnerit (që prek dhe Shqipërinë)
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/15/diplomacia-e-dollarit-e-jared-kushnerit-qe-prek-dhe-sh-qiperine/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:44:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:42:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	562e7a7e7140ef7d0c130d30c876b244ffc4830316d155374f6042b979210b53
TEKSTI	73dced88830ecf550d8fe177fbc02e19a072928a6e6e45c4762b2ec0c97deab
PAMJA	b6fd3843330ce92267ec3ef7078b2ff5bd60c7b04aa8b257099178d54aa8489b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	163dbcfbed7165e91afbedb6382d8e2bfead0107c9e88d0c32d88305ef8bf187
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/163dbcfbed7165e91afbedb6382d8e2bfead0107c9e88d0c32d88305ef8bf187>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Diplomacia e dollarit” e Jared Kushnerit (që prek dhe Shqipërinë)

Aktualitet

Publikuar: 15/09/2026

f X



Në orët e fundit para se SHBA-ja të hynte në luftë me Iranin, në shkurt të këtij viti, Jared Kushner zhvilloi një takim me negociatorët iranianë në Gjenevë – një përpjekje e fundit për të shmangur një konflikt që do të zhyste rajonin në kaos dhe do të trondiste ekonominë botërore. Pas takimit, Kushner i cilësoi bashkëbiseduesit e tij si të padenjë për kohën e tij.

“Plot truke”, u tha ai gazetarëve. “Në thelb po luajnë lojëra me ne kudo dhe janë shumë, shumë të rrëshqitshëm.”

Kushneri, dhëndri i Donald Trumpit, me pamjen e një të riu, është ngarkuar vitet e fundit me një rol të jashtëzakonshëm. Së bashku me Steve Witkoff, të dërguarin special të presidentit, ai është angazhuar për t'i dhënë fund luftërave në Gaza, Ukrainë dhe pothuajse kudo tjetër ku mund të shpërthejnë konflikte.

Kushneri, 45 vjeç, nuk i kushton shumë rëndësi diplomacisë tradicionale. Sipas tij, është më pak e rëndësishme të njohësh historinë e një rajoni apo detajet e qëndrimeve negociuese të palëve, sesa t'i dëgjosh ato dhe të gjesësh një kompromis. Ai ka thënë se marrëveshjet e paqes ngjajnë me marrëveshjet e pasurive të paluajtshme: të dyja kërkojnë negociata të vështira dhe, herë pas here, edhe bllof.

Sipas tij, fakti që shumë diplomatë para tij kanë dështuar nuk tregon vështirësinë e problemeve ndërkombëtare, por paaftësinë e paraardhësve të tij.

“Për dy vitet e fundit jam kritikuar nga të gjithë ata që janë përpjekur dhe kanë dështuar, sepse nuk po e bëj këtë në të njëjtën mënyrë si ata”, deklaronte ai në vitin 2020, pasi Trump

Me të lexuarat

“AMG Food” e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg Nika me blinte të njëjtin buzëkuq çdo të premtë: Punonjësja u përlot kur Mustafa Berishës ndaj Azem Hajdarit nga përgjimi, shantazhi, përjashtimi nga Drejtoria e kërkon Radosław European heqjen e imunitetit të deputetit socialist të Kuvendit të Kosovës Nika, arresti ishte jo proporcional, Gjykata e Lartë lë në burg kryebashkiakun Erio...

prezantoi planin e tij të parë të paqes për Lindjen e Mesme. *“Nëse dikush do të kishte qenë i suksesshëm, unë nuk do të merresha me këtë.”*

Kur Kushner dhe Witkoff nisën takimet me negociatorët iranianë, në shkurt, dy vendet ndodheshin në prag të luftës. Në vitin 2025, forcat amerikane dhe izraelite kishin bombarduar objektet e pasurimit të uraniumit në Iran, të cilat liderët perëndimorë i konsideronin pjesë të një përpjekjeje disa dekadëshe për zhvillimin e një arme bërthamore.

Pas sulmeve, Trump deklaroi se aftësia e Iranit për pasurimin e uraniumit ishte “shkatërruar plotësisht”. Kur kreu i agjencisë më të lartë amerikane të inteligjencës ushtarake kundërshtoi këtë vlerësim të presidentit, ai u shkarkua.

Megjithatë, Trump dhe zyrtarë të tjerë perëndimorë kërkonin lëshime të mëtejshme. Irani vijonte të kishte një rezervë të madhe uraniumi të pasuruar në nivele më të ulëta. Rezerva ishte goposur nën rrënojat e shkaktuara nga bombardimet e vitit 2025, por Trump dhe kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu këmbëngulën që Irani ta dorëzonte atë dhe të hiqte dorë nga çdo synim për pasurimin e uraniumit në të ardhmen.

Trump dërgoi Kushnerin dhe Witkoffin për t’u paraqitur iranianëve një zgjedhje thuajse të prerë: të dorëzonin të gjithë rezervën ose të përballeshin me një sulm. Për ta bërë më të besueshëm kërcënimin, ai kishte dërguar një flotë të madhe ushtarake drejt Lindjes së Mesme.

“Duhet të kemi një marrëveshje kuptimplotë, përndryshe do të ndodhin gjëra të këqija”, deklaroi Trump.

Bisedimet për kufizimin e programit bërthamor të Iranit janë jashtëzakonisht komplekse, me sfida teknike dhe diplomatike. Ato kërkojnë, ndër të tjera, përcaktimin e kapaciteteve të centrifugave që mund të përdoren dhe verifikimin e pretendimeve shpesh të dyshimta të Iranit për çarmatimin.

Megjithatë, as Kushner dhe as Witkoff nuk morën me vete në negociatë një këshilltar teknik. Edhe pse një ekspert nga Departamenti i Energjisë ishte caktuar për të asistuar Witkoffin, ai nuk mori pjesë në bisedime. Shtëpia e Bardhë e mohoi këtë.

Sikur për të treguar besimin e tyre, Kushneri dhe Witkoffi po zhvillonin njëkohësisht negociatë edhe me përfaqësuesit rusë për luftën në Ukrainë. Bisedimet për Iranin zhvilloheshin në mëngjes, ndërsa ato për Ukrainën pasdite.

Një ish-diplomat, i informuar për negociatat me Iranin, tha se kur ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araghchi, nisi të ofronte lëshime, dy negociatorët amerikanë nuk arritën të kuptonin saktësisht se çfarë po ofrohej në tryezë.

Ata kerkuan keshillen e Ratael Grossit, kreut te Agjencise Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, i cili ndodhej në bisedime si palë neutrale.

Një ish-zyrtar i Shtëpisë së Bardhë, që kishte punuar më parë për çështjen bërthamore të Iranit, u shpreh i tronditur nga mungesa e përgatitjes.

“Iranianët vijnë me një propozim. Çfarë do të thotë në të vërtetë? Sa i vonon kjo, dy muaj apo dy vjet? Cilat janë alternativat? Të mos kishin këshilltarë teknikë aty ishte thjesht një dështim total profesional”, deklaroi ai.

Në një konferencë për shtyp pas bisedimeve, Kushner argumentoi se iranienët thjesht po përpiqeshin të fitonin kohë.

“Ata thjesht po përpiqeshin të blinin kohë për të ruajtur gjithçka që mundnin dhe për të kaluar mandatin e Presidentit Trump”, deklaroi ai.

Një ish-zyrtar tjetër i Shtëpisë së Bardhë, me të cilin u diskutua për negociatat, ndante kryesisht të njëjtin vlerësim.

“Ishte e njëjta lojë e vjetër. Qëndrimi i Iranit është: Ne marrim një lehtësim të madh nga sanksionet dhe nuk bëjmë asgjë për të çmontuar infrastrukturën tonë bërthamore”, tha ai.

Megjithatë, disa ekspertë që ndoqën nga afër bisedimet mendonin se propozimet e Araghchit ishin bërë me seriozitet. Mes të tjerash, iranienët ofronin të pezullonin plotësisht pasurimin e uraniumit, diçka që nuk e kishin pranuar më parë, si dhe të hollonin uraniumin e pasuruar që ende mbanin.

Në konferencën për shtyp, negociatorët amerikanë bënë gjithashtu disa deklarata që ngritën pikëpyetje.

Witkoff i akuzoi iranienët se po përdornin Reaktorin Kërkimor të Teheranit, një objekt që prodhon izotope për përdorime mjekësore, për të pasuruar dhe grumbulluar në mënyrë të paligjshme uranium. Megjithatë, inspektimet e përsëritura të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA) nuk kishin gjetur prova për përdorim ushtarak të objektit.

“Duke dëgjuar ato që thonë Kushner dhe Witkoff, kupton se ata nuk i kuptojnë shumë nga çështjet teknike”, tha Kelsey Davenport, eksperte për mospërhapjen bërthamore në Arms Control Association në Uashington.

Një mik i Kushnerit ishte edhe më i drejtpërdrejtë: *“Është një njeri i mrekullueshëm, por është jashtëzakonisht jashtë thellësisë së tij në këtë çështje.”*

Ministri i Jashtëm i Omanit, Badr Albusaidi, që kishte pritur negociatat në Gjenevë, u alarmua nga zhvillimet dhe udhëtoi drejt Uashingtonit në përpjekje për të parandaluar një luftë. Pasi

nuk arriti të takoj me Trumpin, ai u takua me nënpresidentin J. D. Vance, i cili kundërshtonte konfliktin. Më pas, në një lëvizje të pazakontë për një diplomat karriere, Albusaidi doli në CBS dhe bëri thirrje për durim.

“Marrëveshja e paqes është brenda mundësive tona”, deklaroi ai.

Në Uashington, Kushner dhe Witkoff i thanë Trumpit se iranianët kishin refuzuar të kapitullonin. Disa orë më vonë, SHBA-ja dhe Izraeli nisën një seri sulmesh shkatërruese, ku u vranë Ajatollah Ali Khamenei dhe shumë prej drejtuesve të tjerë të lartë të Iranit.

Ish-zyrtari i Shtëpisë së Bardhë tha se administrata ishte nxituar drejt një konflikti të panevojshëm.

“Nuk i fajësoj për një negociatë të dështuar. Por pse më pas, kaq shpejt, nis një luftë dhe eliminohet e gjithë udhëheqja? Thjesht nuk ishte aq urgjente”, tha ai.

Me luftën tashmë të nisur, Kushner dha një tjetër argument për sulmin ndaj Iranit: *“Në thelb, ata mund të kenë qenë, e dini, disa ditë ose javë larg një arme, nëse do të kishin bërë përpjekjet për ta zhvilluar atë.”*

Ky pretendim dukej i pabesueshëm. Që prej sulmeve ndaj objekteve bërthamore të Iranit në vitin 2025, IAEA nuk kishte konstatuar asnjë shenjë të rifillimit të një programi për zhvillimin e armëve bërthamore.

Në fakt, duket se Trumpi u shty drejt konfliktit nga Netanyahu, i cili besonte se një fushatë e koordinuar mund të rrëzonte shpejt regjimin iranian. Kur zyrtarët amerikanë të inteligjencës përcaktuan vendndodhjet e drejtuesve të lartë iranianë, Izraeli vendosi të sulmonte. Në atë pikë, sipas Sekretarit të Shtetit Marco Rubio, Trumpi vendosi se SHBA-ja nuk mund ta shmangte luftën.

“Do të kishte një aksion izraelit. Ne e dinim se kjo do të shkaktonte një sulm ndaj forcave amerikane”, tha Rubio.

Në shtatë muajt që pasuan, administrata Trump është përfshirë në një luftë të kushtueshme, e cila duket se nuk ofron një rrugë të lehtë për t'u përfunduar. SHBA-ja ka bombarduar furnizimet civile me ujë dhe ka goditur aksidentalisht një shkollë për vajza, duke vrarë më shumë se 100 fëmijë. Gjithashtu, ka shpenzuar një pjesë të konsiderueshme të rezervave të raketave të avancuara, duke dobësuar aftësinë për të frenuar kundërshtarë si Kina dhe Rusia.

Ndërsa regjimi radikal iranian është zëvendësuar nga një regjim edhe më i ashpër, administrata amerikane duket se ka humbur në praktikë kontrollin mbi ngushticën e Hormuzit, një nga rrugët ujore më të rëndësishme në botë.

Në edon të dërguar tjetër presidencial, rezultati i negociatave me

Për çdo të dërguar gjatë presidenciale, rezultati i negociatave me Iranin do të ishte një katastrofë. Për Kushnerin, megjithatë, kjo nuk ishte as çështja më e rëndësishme në portofolin e tij. Ndërsa negocionte me Iranin, ai po menaxhonte gjithashtu miliarda dollarë investime që qeveri të tjera të rajonit kishin bërë në fondin e tij privat të investimeve.

Gjatë gjithë epokës Trump, Kushneri e ka ndërtuar karrierën e tij duke ndërthurur biznesin me politikën.

Ai argumenton se përvoja si biznesmen e ndihmon në përpjekjet e tij diplomatike, pasi i jep mundësinë të gjejë zgjidhje krijuese